

INFORMACION PËR KONSUMATORIN

Informacion mbi taksat dhe tatimet e zbatueshme në fushën e sigurimeve

Informacioni kryesor fiskal që lidhet me shërbimet dhe primet e sigurimit, bazuar në legjislacionin shqiptar në fuqi.

**10
%**

Taksa mbi primet e shkruara
10 për qind e shumës së primit, me përjashtimet e përcaktuara nga ligji.

01 Taksa mbi primet e shkruara

Sipas Ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, taksa mbi primet e shkruara është 10% e shumës së primit. Përfshihen primet e sigurimit për produktet e jetës, shëndetit në udhëtim dhe Kartoni Jeshil.

02 Mbledhja e taksës

Shoqëritë e sigurimit të licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) veprojnë si agjente për mbledhjen e taksës mbi primet e shkruara, sipas legjislacionit për taksat kombëtare.

03 Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)

Sipas nenit 53, shkronja “a”, të Ligjit nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shërbimet e sigurimit dhe të risigurimit janë të përjashtuara nga TVSH-ja, përfshirë ndërmjetësimin nga agentët dhe brokerat e sigurimit.

BAZA LIGJORE

- Ligji nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Udhëzimi i AMF nr. 11, datë 08.02.2007, mbi transparencën ndaj publikut dhe mbrojtjen konsumatore.

Ky informacion ka karakter informues. Në rast ndryshimesh ligjore, zbatohen dispozitat në fuqi.